



Република Северна Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ
Republika e Maqedonisë së Veriut
AVOKATI I POPULLIT
Republic of North Macedonia
O M B U D S M A N

Më datë **14.09.2018**, Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi vizitë të rregullt të paparalajmëruar në Stacionin Policor për Kontrolle Kufitare dhe Mbikëqyrje Kufitare (SP për KK dhe MK) Pelince.

Vizita u realizua konform mandatit të Avokatit të Popullit, - Mekanizmi Parandalues Nacional i përcaktuar në Protokollin Fakultativ ndaj Konventës Kundër Torturës dhe Veprimeve tjera Brutale, Johumane, Përçmuese ose Ndëshkuese, me qëllim të përcaktimit të gjendjes reale, përkatësisht gjendjes objektive dhe kushteve në këtë Stacion Policor në drejtim të identifikimit të rreziqeve, me qëllim të parandalimit të torturës ose llojeve të tjera të veprimit brutal, jonjerëzor, përçmues ose ndëshkues.

Vizita në SP për KK dhe MK Pelince filloi me bisedën e eprorit të Stacionit Policor, të cilit iu prezantua mandati dhe kompetencat e Mekanizmit Parandalues Nacional, gjithashtu u bë këqyrje në hapësirat zyrtare dhe atyre ndihmëse, këqyrje në dosjet individuale të personave të arrestuar, të privuar nga liria dhe personat e ndaluar, si dhe në regjistrat të cilët mbahen në Stacionin Policor (Regjistri për ngjarjet e ditës, për personat e thirrur, personat e paraburgosur dhe të ndaluar).

Ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional shpreh shqetësim për faktin se nuk pati mundësi të bëjë këqyrje në Regjistrin për mjetet e përdorura të detyrimit dhe Regjistrin për ankesa kundër nëpunësve policorë të Stacionit Policor, për shkak se çelësi i dollapëve, ku ruhen këta regjistra, ka qenë tek administratori, i cili në momentin e vizitës nuk ishte i aksesshëm për kontakt.

Gjatë vizitës, ekipi i MPN nuk ka vërejtur sende në hapësirat zyrtare të Stacionit Policor, të cilat do të mund të shfrytëzoheshin për shtrëngim ose frikësim.

Ekipi i MPN konstatoi se në SP për KK dhe MK Pelincë zbatohen trajnime për nëpunësit policorë me përmbajtje të ndryshme tematike, në të cilat përfshihen edhe Procedurat Standarde Operative për veprim me kategoritë vulnerabile të personave – të huaj.

Stacioni Policor për KK për MK Pelincë nuk është përcaktuar si Stacion Policor i cili do të mund të kryej ndalimin e personave, dhe për këtë shkak i njëjti nuk ka në dispozicion hapësira të posaçme për ndalim. Në rastet kur ka nevojë për ndalim, varësisht nga shkakun për një gjë të këtillë, personat shoqërohen deri në SPB Kumanovë ose të njëjtit iu dorëzohen nëpunësve të Policisë Pyjore.

Në Stacionin e Policisë nuk ka hapësira për kontroll për azilkërkuesit, e as nuk ka hapësira të veçanta për zhvillimin e bisedave dhe marrjen në pyetje të të paraburgosurve, përkatësisht personave të privuar nga lira ose personave të ndaluar. Bisedat me personat të cilët ka nevojë të ndalohen, zhvillohen në zyrën e nëpunësit e cila ndodhet në pikën e kalimit kufitar, në zyrën e eprorit të Stacionit Policor.

Në hapësirën zyrtare të pikës së kalimit kufitar, përveç Kodeksit të etikës së policisë, në vend të dukshëm, në tri gjuhë, ishin vendosur udhëzimet për të drejtat e personave të thirrur, të arrestuar ose personave të ndaluar, megjithatë vërejtja është se këto udhëzime nuk ishin vendosur në zyrën e eprorit, por ishin vendosur në korridorin e Stacionit Policor.

Ekipi i MPN konstatoi se në këtë Stacion Policor në regjistrat e evidencës vërehen mangësi gjatë plotësimit të një pjese të rubrikave, si dhe se përdoret llaku korrektor.

Për vizitën, Mekanizmi Parandalues Nacional hartoi Raport të Posaçëm në të cilin i konstatoi gjendjet pozitive dhe negative dhe drejtoi rekomandime konkrete deri te Ministria e Punëve të Brendshme, si dhe deri te eprori i Stacioni Policor, me qëllim që të eliminohen mangësitë e theksuara dhe të përmirësohen kushtet dhe veprimi ndaj personave të privuar nga liria, personave të arrestuar dhe personave të ndaluar.